



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 18499/prot.

Vlorë, më 17.08.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____.2026

PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET, BANESAT E TË CILAVE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM URBAN NË BLOKUN E BANESAVE MIDIS RRUGËVE FATOS ARAPI, HASAN KUSHTA, BULEVARDI ISMAIL QEMALI DHE MISTO MELE”.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 27 pika 1, neni 29 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

VENDOSI

- I. Të miratojë dhënien e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar për familjet, banesat e të cilave preken nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban në bllokun e banesave midis rrugëve Fatos Arapi, Hasan Kushta, Bulevardi Ismail Qemali dhe Misto Mele” Rajoni Nr.3 Vlorë . Emrat sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
- II. Afati i përfitimit të bonusit të qirasë për familjet sipas pikës I. të këtij projektvendimi fillon nga momenti i lëshimit të banesës dhe nënshkrimit të marrëveshjes për përfitimin e trajtimit me Bashkinë Vlorë .
- III. Pagesa e qirasë do të rinovohet çdo vit nga data e përfitimit, sipas kontratës së qirasë dhe kushteve të strehimit që parashikohen në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social” të ndryshuar.

- IV. Efektet financiare të pikës I. të këtij vendimi do të mbulohen sipas pikës nr.2, të kreut II. të VKM Nr.409/2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 10799 / prot.

Vlorë, më 17.09 .2026

RELACION

Për projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET, BANESAT E TË CILAVE JANË PREKUR NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM URBAN NË BLOKUN E BANESAVE MIDIS RRUGËVE FATOS ARAPI, HASAN KUSHTA, BULEVARDI ISMAIL QEMALI DHE MISTO MELE”, Rajoni Nr.3 Vlorë.

Nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban në bllokun e banesave midis rrugëve Fatos Arapi, Hasan Kushta, Bulevardi Ismail Qemali dhe Misto Mele”, lagja “Lef Sallata”, Rajoni Nr.3 Vlorë, janë prekur disa objekte me funksion banimi, që rezultojnë të jenë shtesa anësore në pallatet ekzistues ku banojnë familjarët e personave që kanë bërë këto ndërtime për efekt të zgjerimit të hapësirave banimit, por të kundërligjshme. Me Vendimet Nr.46,50,51,55, datë 26.08.2026 dhe Nr.71, datë 15.09.2026 të Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vlorë, është vendosur prishja e tyre, në zbatim të nenit 5 shkronja d, të ligjit nr.9780, datë 17.07.2007 “Për inspektimin e Mbrojtjes së Territorit”.

Për shkak të lëshimit të banesës për efekt të rikualifikim urban të këtij blloku, 5 familje, të cilat mbeten të nën normat e strehimit, për shkak të kufizimit të hapësirës së banimit, ose heqjes së ambjenteve jetësore bazë, kanë vendosur të jetojnë në banesë të marrë me qira në tregun e lirë.

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, kreu II, pika 2, *përfituesit që nuk zotërojnë asnjë banesë tjetër në njësinë e vetëqeverisjes vendore, të ligjshme, apo pa leje, por të legalizueshme, përveç ndërtimit të përjashtuar nga legalizimi, përfitojnë edhe trajtim financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës. Fondet për mbulimin e këtij detyrimi përballohen nga organi përgjegjës.* Për të përfituar nga format e trajtimit me strehim, midis Bashkisë Vlorë dhe këtyre familjeve është lidhur marrëveshja për përfitimin e trajtimit, ose MPT, me të cilën 5 familjet do të trajtohen me bonusin e qirasë për një periudhë 3-vjeçare.

Masa e përfitimit të bonusit të qirasë përcaktohet sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur VKM 409/2022 dhe shprehet në “Marrëveshjen për përfitimin e trajtimit MPT”, e lidhur midis Bashkisë Vlorë

dhe familjeve përfituese. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.107, datë 18.12.2024, janë miratuar vlerat e qirasë mesatare në treg sipas strukturave të apartamenteve dhe subvencioni maksimal i barabartë me 100% të vlerave të qirasë mesatare.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 15.09.2026, mori në shqyrtim trajtimin me bonusin e qirasë sipas Marrëveshjes për përfitimin e trajtimit të familjeve, Axhem Muka, Gjergji Sulejmëni, Astrit Muho dhe Bilbil Ademi, banesat e të cilave janë prekur nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban në bllokun e banesave midis rrugëve Fatos Arapi, Hasan Kushta, Bulevardi Ismail Qemali dhe Misto Mele”, lagja “Lef Sallata”, Rajoni Nr.3 Vlorë. Sipas tabelës referuese nr.1, për familje me 5 anëtarë të rritur në momentin e njoftimit, sipërfaqja e përfitimit është 80 m2, për familje me 4 anëtarë të rritur, sipërfaqja e përfitimit është 70 m2, për familje me 3 anëtar të rritur sipërfaqja e përfitimit është =70 m2, për familje me 2 anëtar të rritur është = 60 m2. Vlerat respektive e qirasë janë 30000 lekë, 25000 lekë dhe 20000 lekë.

Komisioni vendosi të miratojë trajtimin me bonusin e qirasë të këtyre familjeve, me vlerat e përcaktuara sa më sipër.

Sa më lart, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Vlorë të miratojë këtë projektvendim për trajtimin me përfitimin e bonusit të qirasë të familjeve të prekura nga zbatimi i projektit të “Rikualifikim urban në bllokun e banesave midis rrugëve Fatos Arapi, Hasan Kushta, Bulevardi Ismail Qemali dhe Misto Mele”, lagja “Lef Sallata”, Rajoni Nr.3 Vlorë.


Specialiste

Drita Mustafai



DREJTOR

Kristaq Jorgaqi



Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Përbërja familjare	Sipërfaqja/m2	Shuma e bonusit lekë/muaj
1	Astrit Muho	5	80	30000
2	Axhem Muka	4	70	25000
3	Gjergji Sulejmëni	3	70	25000
4	Bilbil Ademi	2	60	20000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 18133 prot.

Vlorë, më 17.09.2026

MIRATOHET
KRYETAR

Brunilda Mersini
Brunilda Mersini

VENDIM

Nr. 13, datë 15. 09. 2026

Mbi miratimin e trajtimit me bonus qiraje të familjeve që janë prekur nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban në bllokun e banesave midis rrugëve Fatos Arapi, Hasan Kushta, Bulevardi Ismail Qemali dhe Misto Mele”, Rajoni Nr.3 Vlorë.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 27 pika 1, neni 29 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë; i mbledhur në datën 15/09/2026

KONSTATOI SE

Nga zbatimi i projektit “Rikualifikim urban në bllokun e banesave midis rrugëve Fatos Arapi, Hasan Kushta, Bulevardi Ismail Qemali dhe Misto Mele”, Rajoni Nr.3 Vlorë, janë prekur disa objekte me funksion banimi, që rezultojnë të jenë shtesa anësore në pallatet ekzistues ku banojnë familjarët e personave që kanë bërë këto ndërtime për efekt të zgjerimit të hapësirave banimit, por të kundërligjshme. Me Vendimet Nr.46,50,51,55, datë 26.08.2026 dhe Nr.71, datë 15.09.2026 të Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vlorë, është vendosur prishja e tyre, në zbatim të nenit 5 shkronja d, të ligjit nr.9780, datë 17.07.2007 “Për inspektimin e Mbrojtjes së Territorit”.

Për shkak të lëshimit të banesës për efekt të punimeve të rikualifikimit të bllokut, pesë familje, të cilat mbeten të nën normat e strehimit, për shkak të kufizimit të hapësirës së banimit, ose heqjes së ambjenteve jetësore bazë, kanë vendosur të jetojnë në banesë të marrë me qira në tregun e lirë.

Për të përfituar nga format e trajtimit me strehim, midis Bashkisë Vlorë dhe këtyre familjeve është lidhur marrëveshja për përfitim të trajtimit, ose MPT, me të cilën 5 familjet do të trajtohen me bonusin e qirasë për një periudhë 3-vjeçare.

Nisur nga dokumentacioni i depozituar pranë Bashkisë Vlorë në mbështetje të kërkesës për të përfituar nga format e trajtimit me strehim, rezuton se;

- familja Astrit Muho në momentin e njoftimit ka qenë me 5 anëtarë, 4 të rritur dhe 1 fëmijë,

-familja Axhem Muka me 4 anëtarë të rritur,

-familja Gjergji Sulejmëni me 3 anëtar të rritur,

-Bilbil Ademi me 2 anëtarë të rritur,

-Kastriot Kaso me 2 anëtar të rritur. Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesëve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, kreu II, pika 2,

përfituesit që nuk zotërojnë asnjë banesë tjetër në njësinë e vetëqeverisjes vendore, të ligjshme, apo pa leje, por të legalizueshme, përveç ndërtimit të përjashtuar nga legalizimi, përfitojnë edhe trajtim financiar në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës. Fondet për mbulimin e këtij detyrimi përballohen nga organi përgjegjës.

Masa e përfitimit të bonusit të qirasë përcaktohet sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur VKM 409/2022 dhe shprehet në “Marrëveshjen për përfitimin e trajtimit MPT”, e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe familjeve përfituese. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.107, datë 18.12.2024, janë miratuar vlerat e qirasë mesatare në treg sipas strukturave të apartamenteve dhe subvencioni maksimal i barabartë me 100% të vlerave të qirasë mesatare.

Sa më lart, komisioni:

VENDOSI

1. Të miratojë përfitimin e trajtimit me bonusin e qirasë të familjeve Astrit Muho, Axhem Muka, Gjergji Sulejmëni, Bilbil Ademi, Kastriot Kaso për një afat 3-vjeçar nga data e lëshimit të banesës për efekt të rikonstruksionit të bllokut të banimit në lagjen “Lef Sallata”, Rajoni Nr.3, Vlorë.
2. Sipërfaqet takuese të strehimit për këto familje të jenë;
 - Astrit Muho =80m²;
 - Axhem Muka = 70 m²,
 - Gjergji Sulejmëni =70 m²,
 - Bilbil Ademi =60 m²,
 - Kastriot Kaso = 70 m²
3. Vlerat e bonusit të qirasë që do përfitojnë këto familje të jenë;
 - Astrit Muho =30000 lekë në muaj,
 - Axhem Muka =25000 lekë në muaj,
 - Gjergji Sulejmëni = 25000 lekë në muaj,
 - Bilbil Ademi =20000 lekë në muaj,
 - Kastriot Kaso= 25000 lekë në muaj.
4. Me vlerësimin dhe vendimin e komisionit të hartohet projektvendimi nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, për tu paraqitur në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë për të miratuar në mbledhjen e këtij muaji.

KOMISIONI:

Klea Lalo Kryetar

Kristaq Jorgaqi anëtar

Mirela Mishgjoni anëtar

Skerdilajd Hunda anëtar

Besi Gjondeda anëtar

Elidon Jaho anëtar

Ledia Sholla anëtar

Hiqmet Gacaj anëtar

Genard Fegaj anëtar

Kanan Shakaj anëtar

Igli Binaj anëtar

Drini Harizaj anëtar

Drita Mustafai anëtar